FEDERATA ESPORTS KOSOVA

FEDERATA ESPORTS KOSOVA (FESK)
PROCESVERBAL
i Kuvendit të Punës dhe Statutar

Data: 28/03/2026
Vendi: Prishtinë

Më 28 mars 2026, në ora 11:00, në Hotel Sirius në Prishtinë, Federata e E-sports e Kosovës mbajti Kuvendin e Punës i thirru në bazë të nenit 6, pika 5 të Statutit të Federatës Esports Kosova, gjatë të cilit u miratuan Raporti i Punës për vitin 2025, Raporti i Auditorit dhe Pasqyrat Financiare për vitin 2025, Plani i Veprimit për vitin 2026, si dhe Plani Financiar për vitin 2026. Në Kuvend morën pjesë delegatë nga klubet anëtare me të drejtë vote. Gjithashtu, të pranishëm ishin edhe përfaqësues nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) si dhe nga Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK).

Rendi i ditës:

1. Hapja e Kuvendit të Punës
2. Zgjedhja e trupave punuese:
    - Kryesia e Punës
    - Formimi i Komisionit përkatës
    - Emërimi i procesmbajtësit
3. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës për vitin 2025
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Aktiviteteve për vitin 2026
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Financiar për vitin 2025

7. Të ndryshme

Zhvillimi i punimeve dhe vendimet:

Pika 1 – Hapja e Kuvendit të Punës
Kuvendi u hap nga Kryetari i FESK-së, z. Altin Preniqi, i cili përshëndeti të pranishmit dhe konstatoi se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e Kuvendit.

Pika 2 – Zgjedhja e trupave punuese
U propozua dhe u votua për përbërjen e trupave punuese: Kryesia e Punës, Komisioni përkatës dhe procesmbajtësi.

Pika 3 – Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
Më pas procesverbali i mbledhjes së kaluar u paraqit për shqyrtim.

Pika 4 – Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës për vitin 2025
Raporti i Punës për vitin 2025 u prezantua në pika të shkurtra nga Kryetari Preniqi, ku pika kyçe ishte organizimi i Kampionatit Evropian në Prihstinë.

Pika 5 – Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Aktiviteteve për vitin 2026
U prezantua Plani i Aktiviteteve për vitin 2026, me theks në zhvillimin e mëtejmë të esports-it në Kosovë dhe projektet strategjike, aty u theksua si pika të veçanta organizimi i turneve për të juniorët e pjesëmarrja në Kampionatin Evropian.

Pika 6 – Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Financiar për vitin 2025
U paraqit Raporti Financiar për vitin 2025, përfshirë edhe raportin e auditorit dhe pasqyrat financiare. Në kwtw pik u pwrmenden edhe vshtirwsti qw ka pasur federata sidomos me obligimet e mbetura pas organizmit tw Evropianit. Kryetari pwrmendi se FESK ka ende rreth 50 mijë euro obligime dhe tha se shpreson qw ato te mund tw kryehn gjatw kwtij viti.

Pika 7 – Të ndryshme
Kuvendi autorizoi Bordin për rizgjedhjen e anëtareve të Komisionit Disiplinor duke u bazuar në statusin e tij. Po ashtu në këtë pikë u diskutua për çështje të ndryshme lidhur me zhvillimin e esports-it në Kosovë. Kryetari theksoi rëndësinë e hapjes së qendrës së trajnimit "FESK Hub", e cila do të shërbejë për identifikimin dhe zhvillimin e talenteve të reja, si dhe për ofrimin e hapësirave për trajnim dhe avancim të ekipeve.

Vendim: Raportet e prezantuara u miratuan unanimisht nga delegatët e u morën parasysh diskutimet dhe rekomandimet e kuvendarëve për zhvillimet e ardhshme.

Përfundimi i Kuvendit

Kuvendi përfundoi punimet në orën 12:30.

Procesmbajtësi: _____

Kryesuesi i Kuvendit: _____

